

Përshëndetje nga Gjirokastra: duke shpresuar se 2009-a ka filluar mbarë për të gjithë Ju, mbetemi me besim në bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj për shpëtimin e Gjirokastrës. Duke ju kujtuar sa e bukur është Gjirokastra nën dëborë ju rekomandojmë të shihni disa foto të saj në linkun: <http://www.gjirokastra.org/flash/gallery/gallery1>



Më poshtë kemi treguar shkurtimisht veprimtarinë e GCDO-së gjatë 3 muajve të fundit. Ju kujtojmë se buletinet tona mund t'i gjeni në adresën tonë: www.gjirokastra.org

1. Projekti për muzeun “Kronikë në gur” në Gjirokastrë – nisje e mirë e fushatës për ngritjen e fondeve

Në tremujorin e fundit të vitit të kaluar GCDO nisi fushatën për gjetjen e partnerëve dhe sponsorëve për zbatimin e projektit të saj për një muze të ri në Kalanë e Gjirokastrës. Projekti, të cilin mund ta lexoni në faqen tonë:

http://www.gjirokastra.org/pdf_files/propozimi_per_muzeun.pdf, u prit me mjaft interes nga shumë institucione shtetërore, lokale, ndërkombëtare, ambasada e biznese. Ministria e



Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka mbështetur projektin dhe ka caktuar tashmë shumën prej 200 000 dollarësh për të kryer rikonstrukcionin e tarracës së Kalasë, sipas projektit të paraqitur nga GCDO. Ky shembull i shkëlqyer sinergjie mes organeve shtetërore dhe OJQ-ve, shënon zgjidhjen e një problemi të trashëguar prej vitesh, gjë që do hapë rrugën për “rijetëzimin” e Kalasë, duke vënë në përdorim potencialin e saj të jashtëzakonshëm turistik.

Philanthropic Collaborative në New York dhe Packard Humanities Institute kanë akorduar tashmë shumat e tyre bujare. Shkrimtari Ismail Kadare ka shprehur përkrahjen tij duke mundësuar edhe huazimin e emrit për muzeun sipas romanit të tij që e bëri të famshme Gjirokastrën në të gjithë botën. Zbatimi i projektit parashikohet të ndahet në faza, nga të cilat faza e parë - restaurimi i galerive në Kala, pritet të kryhet brenda vitit në vazhdim. Për informacione të mëtejshme ju lutemi kontaktoni GCDO-në.

2. Restaurimi dhe rijetëzimi i një mjedisi të papërdorur në Qafën e Pazarit

Në nëntor 2008 Këshilli Kombëtar i Restaurimit miratoi projektin e restaurimit të dyqanit të Omaratëve, të paraqitur nga GCDO. Ky mjedis dykatësh ndodhet në zemër të Pazarit, në itinerarin e zakonshëm të turistëve për në Kala. Prej dy vitesh në katin e parë të saj funksionon shitorja e suvenirëve të artizanatit, që është hapi i parë i përpjekjeve të



Si është



Si do të bëhet

GCDO-së për nxitjen dhe gjallërimin e prodhimit artizanal në Gjirokastrë. 3128 persona, nga të cilët 40% blerës të suvenirëve gjirokastrite, kanë vizituar vitin e kaluar këtë shitore. Kryerja e restaurimit të jashtëm hap rrugën për fazën e dytë: restaurimin e brendshëm që do të pasohet nga krijimi në këtë mjedis (kati i dytë) i një “Inkubatori të Artizanatit”. Projekti është një bashkëfinancim nga qeveria, (restaurimi i çatisë dhe fasadës), PNUD dhe GCDO. Një grup nga Swiss Contact ishte së fundi në Gjirokastrë për të shqyrtuar mundësinë e bashkëfinancimit të “Inkubatorit”. Shpresohet që ky të bëhet një model bashkëpunimi shumëpalësh, duke përfshirë edhe pronarët privatë. GCDO dhe PNUD falënderon familjen Omari për mbështetjen dhe mirëkuptimin e deritanishëm. Njëkohësisht ky projekt synon të jetë model kur restaurimi bëhet që në fillim me qëllime dhe plane të qarta për “rijetëzimin”, dmth futjen në përdorim të ndërtesave historike të papërdorura prej vitesh.

3. Një tunel - bunker i kohës së komunizmit përgatitet të hapet për publikun

Një tunel - bunker me gati 50 dhoma, i ndërtuar në vitet '80 për udhëheqjen komuniste të qytetit do hapet së shpejti. GCDO, në bashkëpunim me Bashkinë e Gjirokastrës, sapo përfunduan fazën e parë të punës, pastrimin dhe rehabilitimin e sistemit të ndriçimit. Përpjekjet tani vazhdojnë për ta kthyer në gjendjen e dikurshme këtë tunel, që ndodhet

nën Kalanë Mesjetare. Për këtë po mblidhen të dhëna për kohën, mënyrën e ndërtimit dhe funksionimit etj. Synimi është që tuneli të sjellë një pjesë të historisë së izolimit komunist të Shqipërisë në vitet '80 tek vizitorët e huaj, por edhe ata vendas, që vijnë në Gjirokastrë për të njohur trashëgiminë e saj kulturore.


Anketimi i kryer vitin e kaluar nga Zyra e Informimit Turistik, konstatoi një interes të veçantë për të vizituar tunelin, kryesisht si shprehje e interesit të vizitorëve për të mësuar për të kaluarën komuniste të Shqipërisë.

4. “ Trashëgimia Kulturore pa Kufinj ” dhe partnerë të tjerë suedezë të Gjirokastrës

Një delegacion nga Gjirokastra i përbërë nga Kryetari i Bashkisë Flamur Bime dhe drejtori i GCDO-së Sadi Petrela, qëndroi në fillim të nëntorit për disa ditë në Suedi me ftesë të shoqatës Culture Heritage without Borders dhe Universitetit Mbretëror të Arteve të Bukura në Stockholm. Të dyja organizatat janë partnerë të rëndësishëm në një program 3 vjeçar restaurimi dhe trajnimi në Gjirokastrë. Qëllimi kryesor i vizitës ishte njohja me përvojën e qytetit Visby, sit i Trashëgimisë Kulturore të UNESCO-s, në administrimin dhe koordinimin e qendrës historike. Një tryezë e rrumbullakët u organizua në Bashkinë e qytetit për të shkëmbyer përvojat në këtë fushë.



5. Rritja e turizmit në Gjirokastrë në 2008



Viti 2008 shënoi një tjetër rritje të turizmit për qytetin e Gjirokastrës. Zyra e Informimit Turistik (ZIT), që vizitohet nga shumica e vizitorëve në Gjirokastrë, ka llogaritur 11 963 vizitorë, një rritje prej gati 100% krahasuar me vitin e mëparshëm. Sipas ZIT, që është një projekt prej dy vitesh i GCDO-së, numri më i madh i vizitorëve të huaj kanë ardhur nga Greqia, pasuar nga Çekia, Gjermania dhe Italia.

6. GCDO merr përvojë nga ICCROM

Menaxherja ekzekutive e GCDO-së E. Roshi mori pjesë në një trajnim një mujor me ftesë të ICCROM (Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Konservimit dhe Restaurimit të Trashëgimisë Kulturore). Trajnimi njëmujor “Vendimarrja gjithëpërfshirëse në konservimin”, u zhvillua në Romë me pjesëmarrjen e 21 specialistëve nga vende të ndryshme. Në zbatim të filozofisë së këtij trajnimi, GCDO shprehet e gatshme të ndajë përvojën dhe njohuritë e saj me këdo që është i/e interesuar. Nëse dëshironi të mësoni më shumë, ju lutem shkruani në adresën eroshi@gjirokastra.org dhe shihni në website-in www.iccrom.org

7. Rriten aftësitë profesionale të stafit të GCDO

Vitin e kaluar stafi i GCDO-së mori pjesë në disa trajnime të organizuar nga British Council (Albania), USAID EDEM dhe Qendra Rajonale e Mjedisit (Regional Environmental Center - REC in Albania). Tre pjesëtarë të stafit morën pjesë në trajnimin njëjavor “Master Class” – Forcimi i Rolit dhe Funkcionit të Organizatave të Shoqërisë Civile për të Promovuar Ndryshimet dhe për të Mundësuar Veprimin në Mjediset Urbane – organizuar nga programi SECTOR i REC-ut dhe mbështetur nga SIDA (Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar.) Çështjet mjedisore janë një përbërës i rëndësishëm në qasjen që GCDO ka për trashëgiminë kulturore të Gjirokastrës dhe në këtë drejtim, ky trajnim ishte shumë i vlefshëm.

8. Gjirokastra promovohet në panairin World Travel Market në Londër



Në mes të nëntorit GCDO, së bashku me Komunën e Antigonesë, mori pjesë në Londër në panairin më të madh të përvitshëm turistik në botë. Ishte rast i shkëlqyer për të promovuar Gjirokastrën dhe Antigonenë si destinacione të turizmit kulturor. Interesi ishte i madh dhe me këtë rast edhe numri i vizitorëve të faqes sonë në internet u rrit dukshëm www.gjirokastra.org

Kryetari i Komunës së Antigonesë Ylli Muho shprehu vlerësimin e tij për pjesëmarrjen në këtë aktivitet në një kohë kur bashkëpunimi me Gjirokastrën për të tërhequr më shumë turistë në këto dy destinacione që ndodhen pranë njeri- tjetrit, po rritet.

Pjesëmarrja në panair u mundësua përmes ftesës së Agjencisë Kombëtare të Turizmit me financim nga programi i përbashkët PNUD-UNESCO “Trashëgimia kulturore për zhvillim shoqëror dhe kulturor”. Ky program financohet nga Fondi Spanjoll për Qëllimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (Spanish Fund for the Millennium Development Goals).

9. Gjirokastra dhe planifikimi i turizmit të qëndrueshëm

Në 20-22 janar 2009 GCDO u ftua të merrte pjesë në një konferencë mbi planifikimin e turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri. Aktiviteti i organizuar nga USAID, mblodhi faktorë kryesorë që veprojnë në Gjirokastrë, në Korçë dhe në bregdetin e Jonit, si dhe donatorë ndërkombëtarë. Gjirokastra u paraqit me përfaqësues nga entet e qeverisjes lokale, media, biznesi, OJF, si dhe komuna e Parku Arkeologjik i Antigonesë. Pjesëmarrësit e organizuar në grupe të pavarura, përcaktuan plane afatshkurtra e afatgjata, si dhe vizionet e tyre për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, që përbëjnë interes për donatorët. Kjo konferencë erdhi pas rezultateve pozitive që një grup ekspertesh nga Aleanca për Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm, pati nga qëndrimi në Gjirokastrë vjeshtën e kaluar, ku u njohën, ndër të tjera, me programet e GCDO-së për zhvillimin e turizmit të trashëgimisë.



Faleminderit !

**Për më shumë informacion rreth GCDO-së dhe përpjekjeve të saj në Gjirokastrë, lutemi drejtojeni drejtorit Sadi Petrela në spetrela@gjirokastra.org ose në cel 06920 78767.*